



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE,
NGRITJE NË DETYRË,
NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreu V – “Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, si dhe planit vjetor të pranimit 2022, të ndryshuar, njësia përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për tre (3) pozicione vakante:

1. **“Inspektor” në Komisionin e Prokurimit Publik - Kategoria: III-a, me profil ekonomist / jurist / inxhinier ndërtimi / inxhinier mjedisi. (tre kandidatë);**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se një pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dyja procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e Dokumenteve:	Shih procedurat përkatëse
Deri në 30.04.2022	Lëvizje paralele
Deri në 05.05.2022	Ngritje në detyrë

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

LËVIZJA PARALELE

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

1. Ushtron funksione ndihmëse dhe këshillimore për Anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik, në kuadër të shqyrtimit të ankesave;
2. Kryen verifikimin e ankesave për plotësimin e kushteve formale në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi të fushës ;



3. Kryen hartimin e akteve që lidhen me shqyrtimin e ankesave dhe draft vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik, brenda afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe/ose brenda afateve të caktuara nga anëtarët e KPP-së;
4. Verifikon çdo element të ankesës si dhe harton projektvendimin përfundimtar nën udhëheqjen e anëtarëve të KPP-së;
5. Siguron ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit që lidhet me çështjet e ngarkuara, si dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët;

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- ç) të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

Arsimimi:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “**Master Shkencor**” në Shkenca Inxhinierike në profilin e Inxhinierisë së Ndërtimit ose Inxhinierisë së Mjedisit, në Shkenca Ekonomike, në Shkenca Juridike.

Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë;

Përvoja:

- Të ketë përvojë pune 1 (një) vit në fushën e prokurimit publik.

Tjetër:

- a- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- b- njohje e mirë dhe përdorim i lirshëm i kompjuterit dhe programeve bazë;
- c- aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentet origjinale (ose të njehësuar me origjinalin) si më poshtë:

- 1) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>;
- 2) Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur, duke specifikuar llojin e procedurës së rekrutimit për të cilin po aplikohet;
- 3) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 4) Fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 5) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 6) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 7) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 8) Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 9) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 10) Aktin e emërimit si nëpunës civil;
- 11) Vërtetimin ku specifikohet kategoria e pagës në pozicionin aktual që ushtron kandidati;
- 12) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi, i cili duhet të jetë i muajit të aplikimit;

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara, sjell **skualifikimin** e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 30.04.2022, në Zyrën e Protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, Blv “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **02.05.2022**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, dhe në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e institucionit, nëpërmjet adresës së e-mailit, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse brenda 3 (tre) ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar;



- Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;
- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- Ligji nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- Vendimi nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.575, datë 10.07.2013 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.1719, datë 17.12.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar;
- Vendimi nr.320, datë 21.4.2011 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 261, datë 17.3.2010 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”;
- Vendimi nr.401, datë 13.05.2015 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimimi ndaj procedurave të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”;
- Vendimi nr.766, datë 13.10.2021 “Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KPP-së”;

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen nga komiteti ad-hoc i Pranimit për Lëvizje Paralele, i ngritur në KPP, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatesisht:

- **Kandidatët do të vlerësohen për përvojën**, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.
- **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**
 - a- njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në lidhjen <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Komisioni në përfundim të vlerësimit, njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komisionin e Brendshëm për Lëvizjen Paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, për zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Komisionit të Prokurimit Publik do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KPP-së. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- NGRITJE NË DETYRË

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është pozicion vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e KPP-së, pas datës 02/05/2022.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për procedurën e ngritjes në detyrë si vijon:

- të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë III-b, IV-a ose IV-b;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- të ketë të paktën vlerësimin e fundit pozitiv “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

Arsimimi:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “**Master Shkencor**” në Shkenca Inxhinierike në profilin e Inxhinierisë së Ndërtimit ose Inxhinierisë së Mjedisit, në Shkenca Ekonomike, në Shkenca Juridike.

Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë;

Përvoja:

- Të ketë përvojë pune 1 (një) vit në fushën e prokurimit publik.

Tjetër:

- a. njohje e mirë dhe përdorim i lirshëm i kompjuterit dhe programeve bazë;
- b. të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- c. aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, **dokumentet origjinalë (ose të njehësuar me origjinalin)** si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>;
- b) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur, duke specifikuar llojin e procedurës së rekrutimit për të cilin po aplikohet;
- c) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- d) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- ë) Akti i deklarimit si nëpunës civil i konfirmuar;
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- gj) Vlerësimin e fundit të rezultateve në punë;
- h) Vërtetimin ku specifikohet kategoria e pagës në pozicionin aktual që ushtron kandidati;
- i) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi, i cili duhet të jetë i muajit të aplikimit;
- j) Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- k) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara, sjell **skualifikimin** e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 05.05.2022, në Zyrën e Protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, Blv “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedurë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e KPP-së duke filluar nga data: 13.05.2022.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Prej datës **13.05.2022**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, dhe në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e institucionit, nëpërmjet adresës së e-mailit, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse brenda (5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar;
- Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;
- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- Ligji nr.125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr.36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- Vendimi nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.575, datë 10.07.2013 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.1719, datë 17.12.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar;
- Vendimi nr.320, datë 21.4.2011 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 261, datë 17.3.2010 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”;
- Vendimi nr.401, datë 13.05.2015 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimimi ndaj procedurave të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”;
- Vendimi nr.766, datë 13.10.2021 “Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KPP-së”;

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen nga Komiteti i Pranimit Ad-hoc për Ngritjen në Detyrë në KPP, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezulttit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në [lidhjen http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015](http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015).

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë kandidatët në portalin “Shërbimi

Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, si dhe në stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Njësia Përgjegjëse njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga dita që komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në (KPND) për rezultatin e pikëve brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KPP-së . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.7

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në faqen zyrtare të KPP-së.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë në këtë procedure, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të kësaj procedure;

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e KPP-së duke filluar nga data **25.05.2022** e në vijim.